



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 14, datë 21.05.2025

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.000.000 LEKË PËR OBJEKTIN "LIDHJA E ENERGJISË DHE UJËSJELLËSIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM SPITALLË"

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025"; Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, si dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 3.000.000 (tremilion) lekë për objektin: "Lidhja e energjisë dhe ujësjellësit në Zonën e Re për Zhvillim Spitallë".
2. Efekti financiar sipas pikës 1 do të sigurohet nga fondi rezerve i buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2025, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024



“Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, si dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027”.

3. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 22.05.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 351/prot.



Durrës, më 28.05.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.14 datë 21.05.2025 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 3.000.000 lekë për objektin “ Lidhja e energjisë dhe ujësjellësit në zonën e re për zhvillimin spitallë”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

